



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 12886 Prot

Vlorë, më 25.10 2023

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e këshillit të bashkisë, datë 30 tetor 2023.

**ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË**

**Për dijëni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORË**

**PREFEKTIT TË QARKUT VLORË**

Ju njoftoj se, **ditën e hënë, datë 30.10.2023, ora 10:00**, në pallatin e kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryetarja e këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, me këtë

**REND DITE :**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 28.09.2023.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin shtator 2023”
3. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin shtator 2023”.
4. Projektvendim “Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë, me emrin “Elham Sulejman Elezaj”.
5. Projektvendim “Për miratimin e sistemit të pikëzimit që do të zbatohet për klasifikimin e familjeve dhe individëve, që kanë aplikuar për të përfituar strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen “Kushtrimi “ Vlorë, sipas programit të Banesave me Kosto të Ulët( BKU).

6. Projektvendim "Për një saktësim në VKB Nr 32, datë 31.03.2023 "Për rinovimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, të Shoqërisë K.F. Oriku".

7. P/V Miratimi i kërkesave, të cilat do të drejtohen administratës, për shpenzime të këshillit të bashkisë për vitin 2024.

8. Të ndryshme.

**Konferenca e Kryetarëve të Grupeve**, do të zhvillojë mbledhjen, ditën e premte, datë 27.10.2023, në mjediset e Bashkisë Vlorë, në orën 09.00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :  
**Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike**, do të mbledhet ditën e premte, datë 27.10.2023, ora 10.00.

**Komisioni i ekonomisë, financave dhe privatizimeve**, do të mbledhet ditën e premte, datë 27.10.2023, ora 11.00.

**Komisioni i shërbimeve publike, transportit dhe strehimit** do të mbledhet ditën e premte, datë 27.10.2023, ora 12.00.

KRYETARE  
Elpiniqi Mërkuri

